

## Depozitë me afate standarde

### Informacion rreth Bankës

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr" Ismail Qemali, Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesasanpaolobank.al

### Karakteristikat dhe rreziqet e Depozitës me afate standarde

#### Karakteristikate Depozitës me afate standarde

Depozita me afat është një depozitë bankare me interes, me një datë të caktuar maturimi që vendoset nga klienti në Bankë për një periudhë kohore fikse dhe të dakordësuar, e cila zakonisht mund të jetë 3M (mujore), 6M,10M, 12M, 15M,18M, 21M, 24M, 36M. Depozita me afat mund të hapen në monedhat e mëposhtme:

3M, 6M,12M, 24M ofrohen në monedhat LEK, EUR, USD, GBP; 21M ofrohet vetëm ne monedhen LEK; 10M, 15M ofrohen në monedhat LEK dhe USD; 36M ofrohet në monedhat LEK, EUR dhe USD; 18M ofrohet ne monedhën EUR.

Në datën e maturimit depozita mund të rinovohet me normën e interesit që publikohet në Kushtet e Punës së Bankës në momentin e rinovimit.

Rinovimi mund të jetë:

- Vetëm Principali, interesi kreditohet në llogarinë rrjedhëse të klientit;
- Principal + Interes (minus tatimin në burim).

Nëse depozita nuk është e rinovueshme, në datën e maturimit principali dhe interesi (minus tatimin në burim) do të kreditohen në llogarinë rrjedhëse të klientit.

Klienti duhet të ketë një llogari rrjedhëse të klientit, të lidhur me depozitën.

#### Tregu i synuar

Tregu i synuar për këtë depozitë janë të gjithë klientët individë që duan të kryejnë investime duke kursyer para për një periudhë afat shkurtër ose afat gjatë dhe në të njejtën kohë të fitojnë interesa.

#### Dokumentet e nevojshme

Mjet identifikimi i vlefshëm: Pasaportë / Kartë Identiteti  
Kontrata e Depozitës

#### Rreziqete Depozitës me afate standarde

**1.** Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

**2.** Llogaria rrjedhëse që lidhet me depozitën me afat është pa komision vetëm nëse përdoret ekskluzivisht për transaksionet e depozitës me afat dhe nuk lidhet me ndonjë produkt tjetër, në të kundërt do të aplikohet komisioni i mirëmbajtjes mujore sipas Kushteve të Punës në fuqi.

**3.** Në rastin e depozitës në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e normave të interesit.

## Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

Normat e Interesit	Periudha				
	3Mujore	6Mujore	1Vjeçare	2Vjeçare	3Vjeçare
<b>Monedha LEK</b>					
≤2,499,999	0.70	0.90	1.35	1.75	2.05
2,500,000-4,999,999	0.85	1.00	1.40	1.80	2.20
5,000,000-9,999,999	0.90	1.10	1.55	1.90	2.30
*10,000,000-24,999,999	0.95	1.20	1.60	1.90	2.30
*≥25,000,000	0.95	1.20	1.75	neg	neg
<b>Monedha EUR</b>					
≤24,999	0.20	0.35	0.70	0.80	0.95
25,000-49,999	0.30	0.45	0.75	0.95	1.10
50,000-99,999	0.35	0.50	0.85	1.05	1.20
*100,000-249,999	0.40	0.55	0.95	1.15	1.30
*≥250,000	neg	neg	neg	neg	neg
<b>Monedha USD</b>					
≤24,999	0.55	0.80	1.20	1.45	1.60
25,000-49,999	0.65	1.00	1.40	1.75	1.80
50,000-99,999	0.75	1.00	1.60	1.95	2.00
*100,000-249,999	0.80	1.05	1.70	2.05	2.10
*≥250,000	neg	neg	neg	neg	neg
<b>Monedha GBP</b>					
≤49,999	0.15	0.20	0.20	0.25	N/A
≥50,000	neg	neg	neg	neg	N/A
<b>Depozitë me afat:</b>	<b>10Mujore</b>	<b>15 Mujore</b>	<b>18 Mujore</b>	<b>21Mujore</b>	
<b>Monedha LEK</b>	1.80	1.90	N/A	2.00	
<b>Monedha EUR</b>	N/A	N/A	1.2	N/A	
<b>Monedha USD</b>	1.10	1.30	N/A	N/A	

Për shumat ≥10,000,000LEK/ ≥100,000EUR/USD, normat e interesit janë subjekt i negociueshëm.

**Shënim:** neg - e negociueshme

### Tatim i mbajtur në burim

Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfitimit të interesit

15% e interesit të përfituar

### Komision rinovimi i Depozitës me Afat

Komision rinovimi për depozitën në LEK	100 LEK
Komision rinovimi për depozitën në EUR	1 EUR
Komision rinovimi për depozitën në USD	1 USD
Komision rinovimi për depozitën në GBP	1 GBP

### Komision Mirëmbajtje

Komision i mirëmbajtjes së llogarisë* LEK/ EUR/ USD/ GBP	Falas
---	-------

\*Për referencë në seksionin e "Rreziqet e Depozitës me Afat".

### Kosto të tjera të lidhura me depozitën

Lëvizjet e aktivitetit të Depozitës	Falas
-------------------------------------	-------

\* Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e levizjes së llogarisë/ve.

Rritja e shumës së depozitës	Falas (e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)
------------------------------	---

Ulja e shumës së depozitës	Falas (e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)
----------------------------	---

Lëshimi i konfirmimit bankar

1,000 LEK  
(opsionale, sipas kërkesës së klientit)**Shembull ilustrativ likujdimi i interes**

Tenor	<b>1Y</b>
Shuma	27,000 EUR
Normë interesi	1.70%
Interesi bruto	459 EUR
Tatim	68.85 EUR
Interesi neto	390.15 EUR
Periodiciteti i interesit dhe pagesës së tatimeve	Në fund të periudhës respektive
Data e likujdimit të interesit	Në fund të periudhës respektive

**Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat**

Tërheqja e pjesshme	Nuk lejohet
Likujdimi i parakohshëm	Lejohet (Shuma e plotë)

Për depozitat 3M, 6M, 10M, 12M, 15M, 21M, 24M nëse depozituesi do të kërkojë përpara datës së maturitetit pagesën e pjesshme ose të plotë të shumës që ka investuar në depozitë, dhe nëse Banka, sipas diskrecionit dhe gjykimit të saj, do të pranojë kërkesën për tërheqje të shumës së investuar në depozitë, atëherë Depozituesi nuk do të përfitojë vlerën e interesit të përlogaritur deri në atë moment.

Për depozitën 36M nëse depozituesi do të kërkojë përpara datës së maturitetit pagesën e pjesshme ose të plotë të shumës që ka investuar në depozitë, dhe nëse Banka, sipas diskrecionit dhe gjykimit të saj, do të pranojë kërkesën për tërheqje të shumës së investuar në depozitë dhe nëse depozita likidohet sipas periudhave të mëposhtme:

- Gjatëvitit të parë, atëherë klienti nuk do të përfitojë interes;
- Gjatë gjysmës së parë të vitit të dytë, atëherë klienti do të përfitojë 50% të interesit të vitit të parë dhe nuk do të përfitojë interesin e akumuluar gjatë vitit të dytë;
- Gjatë gjysmës së dytë të vitit të dytë, klienti do të përfitojë të gjithë interesin e vitit të parë dhe nuk do të përfitojë interesin e akumuluar gjatë vitit të dytë;
- Gjatë gjysmës së parë të vitit të tretë, klienti do të përfitojë të gjithë interesin e vitit të parë dhe 50% të interesit të vitit të dytë, por nuk do të përfitojë asgjë nga interesi i akumuluar i vitit të tretë;
- Gjatë gjysmës së dytë të vitit të tretë, klienti do të përfitojë të gjithë interesin e vitit të parë dhe të dytë dhe nuk do të përfitojë asgjë nga interesi i akumuluar i vitit të tretë.

**Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore**

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e depozitës, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e depozitës nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

**Ankesat**

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: [complain@intesasanpaolobank.al](mailto:complain@intesasanpaolobank.al)
- Në Qendrën e Kontaktit: 08006000

*Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.*

### **Fjalorthi i Termave Kryesore**

**ASD**- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

**Interesi Neto**- vlera bruto e interesit minus tatimin në burim.

**Tatimi ne burim** është një kërkesë e qeverisë për paguesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor të qeverisë Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna, pagesa interesash ose dividendë.

**Penalitet**- Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit.